

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1747/2

18.07.2023

Kërçovë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 23-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 18.07.2023 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 e 25 minuta.

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamer Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emimi, Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, , Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Migjen Zendeli, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini dhe Sibel Tufkegji.

Në seancë morrën pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale të Komunës së Kërçovës: Darko Beleski, Bekim Mustafaj, Aneta Nasteska- Sekretare e Komunës së Kërçovës, Drejtorët e: SHF „Vladimir Polezhinoski, -Kërçovë SHF „Regjë Rushit Zajazi, Zajaz, SHF „Naim Frashëri, -f.Jagoll Dolenci, „Hristo Uzunov, Dërgovë, SHF „Kuzman Josifoski Pitu, SHF „Sande Shterjoski, SHF „Milto Gurra, Strellcë, SHF „Faik Konica, Greshnicë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Procesverbalin nga seanca e 22 e mbajtur më datë 26.06.2023 dhe i njejtë u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR nuk ka, PËRMBAJTUR nuk ka.

Kryesuesi e lexoi propozim rendin e ditës si vijon.

Propozim rendi i ditës

1. Propozim Program për ZHVL për vitin 2023.
2. Propozim Vendim për pjesmarrje me vetëfinancim të Komunës së Kërçovës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projekt infrastrukturor për f.Vraneshticë

3. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Hristo Uzunov" Dërgovë për vitin shkollorë 2023/2023.
4. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Kuzman Josifoski Pitu" Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.
5. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Rexhë Rushit Zajazi" Zajaz për vitin shkollorë 2023/2023.
6. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Sande Shterjoski" Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.
7. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Naim Frashëri" Jagoll Dolencë për vitin shkollorë 2023/2023.
8. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Milto Gurra" Strellcë për vitin shkollorë 2023/2023.
9. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Faik Konica" Greshnicë për vitin shkollorë 2023/2023.
10. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Vlladimir Polezhinoski" Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.
11. Miratimi i Programit për punë për vitin shkollorë 2023/2024 të SHF "Vlladimir Polezhinoski" Kërçovë.
12. Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF "Gjergj Kastriot Skenderbeu" Sërbicë për vitin shkollorë 2023/2023.
13. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PGJU-së për qytetin e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.
14. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në PDU për lagjen "Kalendarica-1"- Blok "B" Komuna e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.
15. Propozim Vendim për dhënien e mbështetjes së njehershme financiare të nxënësve dhe arsimtarve të tyre mentorëve nga shkollat fillore komunale në rajonin e Komunës së Kërçovës, për vitin 2022/2023, për vend të parë të fituar në garat në nivel shtetërorë të organizuara nga shoqatat e akredituara të arsimtarëve.
16. Të ndryshme.

Para miratimit të rendit të ditës, Kryetari i Këshillit propozoi plotësim të rendit të ditës me dy pika të reja nga fusha e urbanizmit:

16. Propozim - Vendim për sjelljen e ndryshim plotësimit të propozimit Planit të detajuar urbanistik për vendbanimin Çiflik UE,,A, Blloku-A6 - pjesa 2 me periudhë planifikuese 2018-2023. (2.171 hektarë) - Komuna e Kërçovës

17. Propozim Vendim për sjelljen e Propozimit Planit të Detajuar urbanistik për vendbanimin “Deveana”, UE,, D, Blloku pjesa - D5 me periudhë planifikuese 2018-2023 (1 hektar) – Komuna e Kërçovës, dhe pika e 16 e rendit të ditës tani të bëhet pika e 18.

Kryetari i këshillit i vendosi për miratim dy pikat e reja të propozuara dhe ato u miratuan me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës të propozuar të plotësuar me dy pikat e reja dhe i njehti u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë) dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

1. PIKA E PARË: Propozim Program për ZHVVL për vitin 2023.

Darko Beleski- Informon se ky program është duke u sjellur më vonë, sepse nuk e kanë ditur se sa mjete do t'u miratohen. Ai theksoi se në të sigurohen mjete që do të përdoren për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për të punësuar të papunë duke hapur kompani të reja në bazë të projekteve të përgatitura. Bëhet me dije se janë kryer kontrolle për projektet dhe janë ndjekur sanksione, nëse nuk plotësohen kushtet.

Viktor Aleksoski - Ai pyeti se nga cila datë këtë vit do të aplikohet për punësim.

Darko Beleski- U përgjigj se do të aplikohet nga shtatori.

Laze Jakimoski- Informon se kishte 2 pyetje:

1. Pse nuk është shpallur thirrja dhe a është dashur të shpallet?

2. Kërkoi një raport të detajuar mbi kontrollin e kryer, për të parë se si është kryer kontrolli.

Darko Beleski - Sa i përket pyetjes së parë, ai u përgjigj se mjetet janë ndarë në bazë të thirrjes publike, por vitin e kaluar nuk ka pasur mjete, ndërsa për pyetjen e dytë ka theksuar se ka një Metodologji për monitorimin e zbatimit të programit në bazë të faturave që kishin me vete dhe mund të kontrollojnë.

Agim Sadiku- Bën me dije se edhe më parë ka kërkuar raport të detajuar për këtë, e jo që të shkojnë individualisht në komunë dhe të bëjnë revizion. Raporti duhet të jetë i detajuar se si zbatohet Metodologjia për projektet dhe procedurat për to dhe gjithçka duhet të jetë transparente.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Program për ZHVL për vitin 2023 dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), APËRMBAJTURT (asnjë).

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për pjesmarrje me vetëfinancim të Komunës së Kërçovës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projekt infrastrukturor për f.Vraneshticë

Darko Beleski- Informon se në muajin maj është shpallur thirrje publike për infrastrukturë komunale dhe publike dhe është bërë aplikim për riparimin e rrugës në f.Vraneshticë dhe së bashku me UNDP-në dhe komunën ka pjesëmarrje vetanake financiare. Ai ka theksuar se është bërë aplikim edhe për pastrimin e lumit të Zajazit, por projekti ende nuk është miratuar.

Agim Sadiku - Ai ka pyetur pse nuk është miratuar projekti për pastrimin e lumit të Zajazit

Darko Beleski - Ai informon se mjete kanë marrë vetëm 4 komuna. Është bërë dokumentacioni teknik për lumin e Zajazit nga f.Mahmude deri në stadiumin e Napredokut. Kishte një problem me marrëdhënie të pazgjidhura pronësore në tregun e kafshëve dhe nuk kaloi, u refuzuan dhe ende presin një shpjegim zyrtar për të.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Propozim Vendim për pjesmarrje me vetëfinancim të Komunës së Kërçovës për përgatitjen e dokumentacionit teknik për projekt infrastrukturor për f.Vraneshticë dhe e njëjta u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë) .

3. PIKA E TRETË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit për shkak të motit të nxehtë sugjeroi që diskutimi të jetë në një paketë për shkollat.

Agim Sadiku – Ai theksoi që të mos humbet kohë, nëse dikush ka pyetje për shkollën përkatëse, le ta bëjë dhe të marrë përgjigje.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Valentina Lazarevska - Informon se raportet janë bërë pro-forma, nuk ka pasur renditje kronologjike në lidhje me programin dhe sa janë përmbushur kushtet e parapara në program. Raportet ishin copy paste, tani kishte programe të reja, lëndë të reja zgjedhore që nuk ishin në raporte, kishte shumë gabime dhe të dhëna në raportet që nuk ishin më në përdorim dhe ajo dha shembuj për këtë. Ajo propozoi qasje më serioze në përgatitjen e raporteve dhe informoi se do të abstenojnë nga votimi për disa prej tyre.

Kryetari i këshillit theksoi se duhet t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen.

Agim Sadiku - Ai sugjeroi që Sektori i Arsimit të përgatisë një shabllon dhe sipas tij të punojnë shkollat.

Valentina Lazarevska- Informon se drejtorët raportet vjetore i përgatisin në bazë të programeve vjetore dhe raportin duhet ta rregullojnë në bazë të realizimit të programit.

4. PIKA E KATËRT: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Rexhë Rushit Zajazi” Zajaz për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit vuri për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Rexhë Rushit Zajazi” Zajaz për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (asnjë).6 vota PËRMBAJTUR .

6. PIKA E GJASHTË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Sande Shterjoski” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Sande Shterjoski” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

7. PIKA E SHTATË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Naim Frashëri” Jagoll Dolencë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit vuri për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Naim Frashëri” Jagoll Dolencë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kaloi në:

8. PIKA E TETË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Milto Gurra” Strellcë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Milto Gurra” Strellcë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (asnjë).6 vota PËRMBAJTUR .

9. PIKA E NËNTË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Faik Konica” Greshnicë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Faik Konica” Greshnicë për vitin shkollorë 2023/2023. dhe u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (asnjë).6 vota PËRMBAJTUR .

10. PIKA E DJETË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Miratimi i Programit për punë për vitin shkollorë 2023/2024 të SHF”Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Programit për punë për vitin shkollorë 2023/2024 të SHF”Vlladimir Polezhinoski” Kërçovë dhe u miratua me me 23 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

12. PIKA E DYMBËDHJETË: Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Gjergj Kastriot Skenderbeu” Sërbicë për vitin shkollorë 2023/2023.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit vjetorë për punë të SHF”Gjergj Kastriot Skenderbeu” Sërbicë për vitin shkollorë 2023/2023 dhe u miratua me 16 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 7 vota PËRMBAJTUR .

13 PIKA E TREMBËDHJETË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PGJU-së për qytetin e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.

Kryetari i Komisionit për Planifikim Urbanistik , Laze Jakimoski, informoi se Komisioni për Urbanizëm është takuar dhe i ka shqyrtuar pikat e urbanizmit dhe i ka njoftuar me Raportin e Komisionit.

Bekim Mustafaj – Ai bën me dije se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti në pronësi private

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim i PGJU-së për qytetin e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje dhe u miratua me 23 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

14. PIKA E KATËRMBËDHJETË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të silllet ndryshim në PDU për lagjen “Kalendarica-1”- Blok “B” Komuna e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje.

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti të ndërtuar pa leje, me një pjesë e të cilit është objekt afarist dhe një pjesë objekt ndihmës. Një pjesë e saj është në zonë të gjelbërt shtetërore dhe është kërkuar që të hiqet.

Abdulla Sejдини - Informon se në Raportin për Urbanizëm ka vërejtje në pikën e dytë, nuk është miratuar me 2 vota PËR, por me 2 vota KUNDËR dhe ka kërkuar që të korigjohet. Ai theksoi se një pjesë e objektit është në pronësi shtetërore dhe kishte lëshim. Ai pyeti nëse do të kishte lëshime edhe për objekte të tjera të tilla apo nëse duhet të ndërpritet

Igor Stojanoski - Ai informon se bëhet fjalë për legalizimin e një objekti të ndërtuar pa leje me mjetet e komunës, pyeti pse duhet të paguaj komuna, e jo ai që kërkon.

Bekim Mustafaj- Bën me dije se kështu e ka kërkuar ligji.

Kryetari i këshillit ka vendosur për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të silllet ndryshim në PDU për lagjen “Kalendarica-1”- Blok “B” Komuna e Kërçovës, për shkakë të përfshirjes së objektit pa leje dhe e njëjta nuk është miratuar me 0 vota PËR. 11 vota KUNDËR, dhe 12 vota PËRBAJTUR.

15. PIKA E PESËMBËDHJETË: Propozim Vendim për dhënien e mbështetjes së njëhershme financiare të nxënësve dhe arsimtarve të tyre mentorëve nga shkollat fillore komunale në rajonin e Komunës së Kërçovës, për vitin 2022/2023, për vend të parë të fituar në garat në nivel shtetërorë të organizuara nga shoqatat e akredituara të arsimtarëve.

Kryetari i këshillit bën me dije se ka diskutuar me propozuesin se për cilët studentë bëhet fjalë, për cilat gara bëhet fjalë për shtetërore, ndërkombëtare, a janë të akredituar apo jo. Për këtë duhet të parashikohen mjete në buxhetin e komunës etj.

Valentina Lazarevska - Informon se qëllimi ishte motivimi i mësimdhënësve dhe nxënësve. Në faqen e internetit të Ministrisë janë të listuara 12 shoqata të akredituara. Ajo shpjegoi nenin 2 të Vendimit dhe bëri të ditur se bëhej fjalë për fitimin e vendeve

të para për 3 nxënës: një nxënës në dy gara në lëndën e Matematikës dhe dy nxënës në garën shtetërore në Gjeografi.

Kryetari i këshillit bëri me dije se kjo është në rregull, por është dashur të rregullohet mënyra e zbatimit dhe të plotësohet pika.

Valdet Selimi - Njofton se nëse miratohet Vendimi ai do të publikohet në „Gz. Zyrtare„. Ai propozoi tërheqjen e pikës nga rendi i ditës dhe plotësimin e Vendimit.

Laze Jakimoski - Informon se në nenin 2 të Vendimit thuhet se si të kryhet procedura. Për seancën e radhës mund të bëhet ridestnimi i mjeteve për këto nevoja.

Ivanço Bozhinoski - Ai sygjeroi që të diskutohet me Sektorin e Financave dhe kjo pikë të shqyrtohet në seancën e ardhshme.

Sekretari i Komunës – bëri me dije se është diskutuar edhe në Komunë. Është dashur t'u drejtohem komunave të tjera që kanë studentë dhe mentorë të tillë dhe sipas mjeteve në buxhet ta rregullojnë dhe ta bëjnë të përgjithshëm.

Kryetari i këshillit kërkoi që pika të tërhiqet nga kjo seancë, të rregullohet dhe të vendoset në seancën e radhës. Ai theksoi se të gjithë ishin në favor të kësaj pike.

Anto Trajanoski - Ai kërkoi që të mos nxitohet me pikën, të rregullohet dhe të sillet në seancën e ardhshme.

Laze Jakimoski - Ai pyeti se kush do ta precizojë vendimin për seancën e ardhshme.

Sekretari i komunës bëri me dije se do të bëhet nga Sektori i Arsimit.

Propozuesi e tërhoqi pikën për seancën e radhës me qëllim për ta rregulluar atë.

16. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË : Propozim - Vendim për sjelljen e ndryshim plotësimin të propozimit Planit të detajuar urbanistik për vendbanimin Çiflik UE,,A, Blloku-A6 - pjesa 2 me periudhë planifikuese 2018-2023. (2.171 hektarë) - Komuna e Kërçovës

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për ndryshim dhe plotësim të PDU-së për vendbanimin Çiflik, me vetëfinancim nga palët, i k të gjitha pëlqimet dhe ka qenë e nevojshme që të miratohet nga këshilli.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim - Vendim për sjelljen e ndryshim plotësimit të propozimit Planit të detajuar urbanistik për vendbanimin Çiflik UE,,A, Blloku-A6 - pjesa 2 me periudhë planifikuese 2018-2023. (2.171 hektarë) - Komuna e Kërçovë dhe e njëjta u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 8 vota PËRMBAJTUR.

17. PIKA E SHTATËMBËDHJETË: Propozim Vendim për sjelljen e Propozimit Planit të Detajuar urbanistik për vendbanimin “Deveana”, UE,, D, Blloku pjesa - D5 me periudhë planifikuese 2018-2023 (1 hektar) – Komuna e Kërçovës.

Bekim Mustafaj - Ai bën me dije se edhe kjo pikë është e njëjtë dhe bëhej fjalë për vetëfinancim nga palët për një bllok në vendbanimin Deveana.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për sjelljen e Propozimit Planit të Detajuar urbanistik për vendbanimin “Deveana”, UE,, D, Blloku pjesa - D5 me periudhë planifikuese 2018-2023 (1 hektar) – Komuna e Kërçovës dhe u miratua me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 7vota PËRMBAJTUR.

18. PIKA E TETËMBËDHJETË: Të ndryshme

Kryetari i këshillit lexoi kërkesën e qytetarëve të rrugës “Diço Vojvoda”, për renovimin e rrugës në të cilën janë kryer disa aktivitete ndërtimore. Ai bën me dije se është diskutuar me NK Komunalec për këtë dhe se do ta rinovojnë rrugën gjatë javës.

Valentina Lazarevska - pyeti sekretarin e komunës nëse këtë vit do të ketë thirrje publike për kondicionerë inverter, sepse ka pasur interesim të madh nga qytetarët.

Sekretari i Komunës: u përgjigj se deri në fund të vitit do të ketë thirrje publike për inverter.

Igor Stojanoski - Kërkoi që pankartat në të cilat shkruhej "Mirë se vini mërgimtarë", të cilat ishin në gjuhën shqipe, të vendosen edhe në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën turke dhe për këtë të merret një konkluzion. Kjo të bëhet në një kohë sa më të shkurtër, për të respektuar të gjithë njerëzit që jetojnë në qytet dhe paguajnë taksa.

Kryetari i këshillit - Kërkoj që të shënohet si vërejtje në procesverbal nga ana e këshillit, që pankartat përveç gjuhës shqipes të vendosen edhe në gjuhën maqedonase dhe turke.

Laze Jakimoski - Ai pyeti nëse pankartat i vendos komuna. Informoi se ka pasur shkelje të ligjit për gjuhët. Ai e mbështeti Igorin dhe theksoi se vërtet ka pasur shumë reagime nga qytetarët, ajo kërkesë është legjitime dhe duhet respektuar ligji.

Kryetari i këshillit: Ai bëri me dije se si shqiptarë ato nuk i shqetëson gjuha e të tjerëve, ai u pajtua me konkluzionin dhe se nuk ishte problem për ta dhe ndoshta mbeti si pasojë e politikave.

Laze Jakimoski - Ai theksoi se pajtohet me arsyetimin e kryetarit.

Valbona Adili-Informon se Igori këtë e ka kërkuar edhe vitin e kaluar dhe duhet të zbatohet.

Abdulla Sejdini- Informon se do të kërkojë edhe nga kryetari i Komunës në Butell që të respektohen gjuhët edhe atje, ai theksoi se ishte PËR.

Meqenëse askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe kështu u shterë rendi i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 12:00.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

-Elisaveta Mileska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.

